


Merinele Ziu

Per ankim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË KAVAJE

Adresa : Unaza e re " Kavaje

Tel/fax 055242250

Nr. 2026 Prot(D.B).

Kavaje, me 24./5/2021

LËNDA:Dërgohet për njoftim vendimi i mosfillimit te procedimit .

DREJTUAR:

- 1-Partia Demokratike e Shqiperise, Tirane ✓
- 2- [REDACTED], Bashkia Rrogozhine.
- 3- [REDACTED], Bashkia Rrogozhine

Bashkëlidhur ju dërgojmë vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr 235 vitit 2021

DREJTUESI I PROKURORISË

DURIM BËDINI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS PARE KAVAJË

V E N D I M

“Për mosfillimin e proçedimit penal”

Në Kavajë, Viti 2021, Muaji Maj, date 10

Unë Durim Bedini, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, pasi studiova, mora në shqyrtim dhe vleresova aktet e kallzimit penal nr 235 dt 27.04.2021

K O N S T A T O V A se :

Me date 27.04.2021 janë regjistruar aktet e kallzimit penal nr 235 lidhur me kallzimin e subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë ndaj shtetasve [REDAKTUAR], dhe [REDAKTUAR], akuzuar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 K.Penal.

Nga verifikimet e kryera për këtë kallzim penal ka rezultuar se:

Me date 18.04.2021 rezultoi i depozituar nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Gazmend Bardhi, ku nga ana e kallzuesit është pretenduar kryerja e veprave penale të “Shpërdorimit të detyrës “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, “Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikuara nga nenet 248, 328, 328/a të Kodit Penal.

Referuar materialit të paraqitur rezultoi se nuk ka të dhëna për veprën penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal.

Gjithashtu, nuk ka të dhëna për veprime të kryetarit të bashkisë, të përmendur në kallëzim, që do të përbënin elementë të ndonjë veprë penale, si subjekt i posaçëm.

Nga kallëzimi pretendohet edhe për veprime të Shefit të Emergjencës Civile në Bashkinë Rrogozhinë, shtetasi [REDAKTUAR] duke përdorur asete dhe burime njerëzore të administratës shtetërore, duke shpërndarë ndihma shtetasve të ndryshëm, me qëllim ndikimin në fushatën zgjedhore dhe ndryshimin e rezultateve zgjedhore.

Në kuader të zgjedhjeve parlamentare të datës 25.04.2021 subjekti politik Partia Demokratike pretendon se të paktën 4 muajt e fundit është vënë re shtim në masë i veprimeve të kundraligjshme nga ana e qeverisë, duke përdorur çdo mjet dhe mënyrë të paligjshme në funksion të ndikimit tek vullneti i qytetarëve dhe ndryshimit të rezultatit të zgjedhjeve në favor të Partisë Socialiste.

Gjatë kësaj periudhe pretendohet se janë shtuar së tepërmi ndihmat ndaj qytetarëve në pamundësi ekonomike apo familjeve në nevojë, pasi ky grup shoqëror zë dhe pjesën më të madhe të popullsisë i cili përdoret masivisht për fushatë elektorale për të maksimizuar votën për Partinë Socialiste.

Më datë 18.03.2021 në Lagjen numër 1 në Rrogozhinë gjatë orarit zyrtar të punës, shtetasi [REDAKTUAR] në Bashkinë Rrogozhinë, ka shpërndarë ndihma në

batanije dhe veshmbathje në këmbim të votes, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë [REDAKTUAR] në funksion të maksimizimit të paligjësëm të votave për Partinë Socialiste.

Ne kallzim pretendohet se nuk është një rast sporadik apo i veçuar, por në vijim të aktivitetit elektoral të përditëshëm, i cili konsiston në shpërndarjen e ndihmave në këmbim të votës për Partinë Socialiste, i cili ka përdorur makinën në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë për shpërndarjen e ndihmave në familje të ndryshme, në kundërshtim të plotë me ligjin.

I pyetur si person që ka dijeni për veprën penale shtetasi [REDAKTUAR] deklaron se aktualisht është punonjes pranë Bashkisë Rrogozhine me detyrën e specialistit të emergjencës civile dhe konkretisht detyra e tij funksionale është të ndihmojë familjet në nevojë në raste fatkeqesish, si termeti ,pandemia,permbytjet, etj si dhe për familjet në nevojë ekonomike. Pas rënies së termetit të datës 26.11.2019 Bashkia Rrogozhine rezultoi se ka marrë në mënyrë të përsëritur ndihmë nga rezervat e shtetit për familjet e goditura nga kjo fatkeqësi, që konsistojnë në çadra, veshmbathje, dysheqe, batanije dhe ushqime të ndryshme. Bazuar në nevojat që ka për këto familje të evidentuara nga punonjësit e Bashkisë i drejtohen prefekturës Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, dhe në mbështetje të kërkesës së tyre Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit bënte mundur furnizimin e mallrave të kërkuara nga ana e tyre të cilat pasi magazinohen fillon shpërndarja sipas kërkesave të bëra nga administratoret e Njësive Administrative dhe grupi i punës së Bashkisë Rrogozhine fillon shpërndarjen e këtyre ndihmave në familjet në nevojë, kjo bazuar në një listë me kryefamiljaret të cilët firmosin për ndihmat që marrin duke paraqitur dhe kartën e identitetit.

Në lidhje me fotografite e vena në dispozicion ai deklaron se i përkasit datës 18.03.2021 dhe ndodhet në lagjen "Kariatasit" Rrogozhine në familjen Sinanaj , kryefamiljarja së cilës jeton e vetmuar dhe në gjendje të rëndë ekonomike. ndërsa në lidhje me kamioncinën ai deklaron se është në pronësi të Bashkisë Rrogozhine e cila përdoret për nevojat e kësaj Bashkie, dhe konkretisht atë ditë sipas urdhër shpërndarjeje ka tërhequr mallin nga magazina e Bashkisë për tua ndarë familjeve në nevojë sipas një grafiku të nxjerre nga grupi i punës .

Është mbajtur proces- verbal " Për kqyerjen dhe marrjen e dokumentave " dt 06.05.2021 si më poshtë:

Flete –hyrje nr 15 dt 01.03.2021, flete –hyrje nr 16 dt 02.03.2021, flete –hyrje nr 18 dt 05.03.2021, flete –hyrje nr 19 dt 11.03.2021, flete –hyrje nr 20 dt 11.03.2021, flete –dalje nr 159 dt 25.03.2021, flete –dalje nr 160 dt 25.03.2021, proces-verbal dt 18.03.2021.

Gjithshtu i pyetur në se këto veprime janë kryer në mënyrë të paligjshme duke ndikuar tek vullneti i qytetarëve në rezultatin e zgjedhjeve në favor të subjektit të partisë socialiste, ai deklaron se ka rreth dy vjet që ndihmon familjen në nevojë dhe kjo nuk ka të bëjë me fushatën zgjedhore , pasi Bashkia Rrogozhine shpërndan vazhdimisht ndihmë për familjet në nevojë, kjo sipas kërkesave të administratoreve të Njësive Administrative të cilat administrohen në Bashki, nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale nxirret urdhër bashkë me listën përkatëse të familjeve në nevojë dhe fillon shpërndarja e këtyre ndihmave.

Në zërvatje të elementeve të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilën edhe është rregjistruar kallzimi penal, duhet nënvizuar se vepra penale;

Kryerja ose mos kryerja e veprimeve në kundërshtim me ligjin që përben në mospermbushje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron detyrë publike ,kur i ka sjelle atij ose personave të tjerë ,kur kanë sjelle përfitime materiale ose jo materiale të pa drejta ose kanë demtuar interesat e ligjshme të shtetit të shtetasve dhe personave të tjerë juridike.....

Ne rastin konkret, veprimet e kryera nga shtetasi [REDACTED] jane ne perputhje dhe ne zbatim te ligjit,gjithashtu nuk ka të dhëna për veprime të kryetarit të bashkisë, të përmendur në kallëzim që do të përbënin elementë të ndonjë vepre penale,

Pra: Nuk ka asnje veprim aktiv te kundraligjshem qe te jete ne kundërshtim me Ligjin, çdo veprim i tij eshte ne funksion dhe permbushje te rregullt te detyres.

Nenet 280-283-287 K.Pr.Penale,parashikojne qarte rastet e referimit dhe regjistrimit te fakteve qe konstatohen apo kallezohen por qe perbejne veper penale .

Fakti i paraqitur ne materialin kallzues nuk parashikohet nga ligji si veper penale ndaj duhet vendosur mosfillimi.....

Nga analiza e të gjithë argumentave dhe rrethanave të paraqitura në këtë kallëzim penal,rezulton se ekzistojnë shkaqe ligjore të cilat nuk lejojnë fillimin e ketij procedimit penal.

Sa më sipër, në mbështetje të neneve 290,pika 1,shkronja “ç”,dhe 291 të K.Pr.Penale.

V E N D O S A :

1-Mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin penal Nr 235 dt.27.04.2021

2.Të njoftoj me këtë vendim personat e interesuar të cilët kanë të drejtën e ankimit brenda 10 diteve nga dita e njoftimit në Gjykatën prane Shkalles se Pare Kavaje.

PROKURORI
DURIM BEDINI

